



Prishtinë, 28 janar 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1091_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084),
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtitshme të Energjisë,
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Lokacionin Sfaraçak i Ulët, me kapacitet të instaluar prej 10 kW në Komunën e Vushtrrisë, të datës 18.12.2018 me nr. prot. 297/2018 të Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë -IADK., me adresë: fshati Sfaraçak i Ulët nr. 11, Komuna e Vushtrrisë Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 28 janar 2019 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. APROVOHET-** kërkesa e Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë - IADK”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Lokacionin Sfaraçak i Ulët, me kapacitet të instaluar prej **10 kW**, në ngastrat kadastrave P-70202029-00352-20 ZK Sfaraçak, Komuna e Vushtrrisë.
- II. OBLIGOHET** - Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë - IADK me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DMI-9043660 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrij kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III.** ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV.** Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë – IADK do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.



Arsyetim

- ZRRE, me datë 18.12.2018 nga Inicativës për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë – IADK ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Lokacionin Sfaraçak i Ulët, me kapacitet të instaluar prej **10 kW**, në ngastrat kadastrave P- 70202029-00352-20 ZK Sfaraçak, Komuna e Vushtrrisë.
- Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë – IADK s’bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetorë të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergetik nr. 12741 të datës 15.11.2018 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Vushtrrisë.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së Inicativës për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë - IADK”, dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum nga panelet solare/fotovoltaike në Lokacionin Sfaraçak i Ulët, me kapacitet të instaluar prej **10 kW**, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Vushtrrisë
- KEDS SH.A.,dhe
- Arkivit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar